



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1899/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI165/21

Parashtrues

Hasret Bekteshi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hasret Bekteshi, me vendbanim ose vendqëndrim të panjohur (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i pretenduar i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilin vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria) e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së pretenduar është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 shtator 2021, parashtruesi i pretenduar i kërkesës dorëzoi përmes postës elektronike një shkresë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 9 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 24 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e pretenduar të kërkesës përmes postës elektronike për regjistrimin e kërkesës. Me të njëjtën shkresë, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës, që brenda 15 ditëve, a) të plotësojë formularin standard të kërkesës, b) të tregojë numrin e Vendimit të Qeverisë që ai e konteston, c) të deklarojë dhe të shpjegojë se cilat mjete juridike i ka përdorur me qëllim të kontestimit të vendimit të paspecifikuar të Qeverisë para se ta dorëzojë kërkesën në Gjykatë, d) të deklarojë dhe shpjegojë se si vendimi i paspecifikuar i Qeverisë shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë sipas nenit 23 të Kushtetutës, e) të paraqes prova në Gjykatë se ai është nëpunës publik, siç ka thënë në shkresë.
8. Gjykata thekson se ai e dërgoi shkresën e tij në adresën elektronike nga e cila Gjykata e mori kërkesën e pretenduar nga parashtruesi i pretenduar i kërkesës, dhe të cilën ai e dha si adresë për komunikim me Gjykatën.
9. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk iu përgjigj shkresës së Gjykatës të 24 shtatorit 2021 brenda afatit të caktuar.

10. Më 4 nëntor 2021, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës refuzim të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se më 1 shtator 2021, Gjykata pranoi një shkresë përmes postës elektronike nga Hasret Bekteshi, i cili paraqitet si parashtruesi i pretenduar i kërkesës, dhe i cili nuk dha asnjë të dhënë tjetër personale përveç emrit të tij të pretenduar.
12. Në atë shkresë, parashtruesi i pretenduar i kërkesës deklaroi *“Ankesa ime bazohet në pikën lidhur me sigurin në punë Pika C neni 8 ku shkelet kushtetuta”*.
13. Gjithashtu, parashtruesi i pretenduar i kërkesës i ka bashkëngjitur asaj shkrese një vendim të Qeverisë i cili ishte pa numër, datë, nënshkrim apo vulë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i pretenduar i kërkesës në shkresë deklaroi, *“se shkelet neni 23 i kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku ai si punëtor në institucionet e Kosovës kushtëzohet se nëse nuk është i vaksinuar nuk mund të hyj në punë ose të testohet çdo ditë”*.
15. Parashtruesi i pretenduar i kërkesës nuk kishte ndonjë kërkesë të posaçme para Gjykatës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Gjykata në vazhdim i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

[...].

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

19. Në kontekstin e dispozitave të mësipërme, Gjykata thekson se në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, palët duhet të kontestojnë një akt të caktuar të autoritetit publik në Gjykatë. Përveç kësaj, në bazë të nenit 48 të Ligjit, përveç deklaramentit të aktit specifik të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë të detyruara të deklarojnë qartë se cilat të drejta dhe liri ata pretendojnë se u janë shkelur. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi, pavarësisht kërkesës së Gjykatës për sqarim, (i) nuk deklaroi para Gjykatës aktin e autoritetit publik i cili kontestohet, dhe (ii) nuk sqaroi cilat të drejta themelore dhe liri ai pretendon se i janë shkelur.
20. Gjykata rikujton se, më 1 shtator 2021, përmes postës elektronike kishte pranuar një shkresë nga Hasret Bekteshi, i cili paraqitet si parashtrues i pretenduar i kërkesës. Duke qenë se kërkesa nuk ishte e kompletuar dhe nuk përbante të dhëna të vlefshme, informata dhe as vendimin e specifikuar të Qeverisë të cilin e konteston, më 24 shtator 2021, në pajtim me paragrafin 4, të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të plotësojë kërkesën e tij duke (i) plotësuar formularin standard të kërkesës, (ii) duke deklaruar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston; (iii) të sqarojë saktësisht pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë; dhe (iv) të dorëzojë dëshmi në Gjykatë se ai është nëpunës publik, siç ka deklaruar në shkresë.
21. Gjykata e dërgoi shkresën e saj në adresën e postës elektronike nga e cila e mori letrën nga personi që paraqitej si parashtrues i pretenduar i kërkesës, të cilin ai e dha si adresë për komunikim me Gjykatën. Gjykata i dha parashtruesit të pretenduar të kërkesës afat prej 15 ditëve për të dorëzuar në Gjykatë dokumentet dhe informatat e kërkuara.
22. Gjykata thekson se personi i pretenduar, i cili paraqitet si parashtrues i kërkesës nuk i ka dorëzuar dokumentet e kërkuara, informatat dhe sqarimet brenda afatit kohor.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën”.

[...]

24. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit me një kërkesë të tillë, por pa sukses.
25. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret është e paqartë (i) cilin akt të autoritetit publik parashtruesi e konteston në Gjykatë; (ii) cilat janë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese; dhe (iii) bazuar në shkresat e lëndës dhe përmbajtjen e tyre, faktet e rastit janë të pakuptueshme.
26. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç përcaktohet në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
27. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër (shih rastin KI89/18, parashtrues *Agim Jashari*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 27 nëntorit 2018, paragrafi 29, dhe rastin KI74/18, parashtrues *Gëzim Murati*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26, KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, parashtrues *Hilmi Aliu dhe të tjerët*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 11 nëntorit 2020, paragrafi 33; KI90/20, parashtrues *Arben Boletini*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 25 nëntorit 2020, paragrafi 25).
28. Përfundimisht, në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 4 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Presa Caka-Nimani